

**Shënja Familjare:**

Ju lutemi uluni me gjithë familjen tuaj në tryezën e caktuar, zgjidhni një shenjë dhe çdo pjesëtar i familjes të zgjedhë një artikull që t'a vendosë në shenjën dalluese të familjes tuaj. Konceptojeni si grup me familjen tuaj shenjën tuaj dalluese. Pasi kjo shenjë dalluese të jetë plotësuar, ndajeni mepjesëtarët e familjes ç'ka ata kanë zgjedhur si shenjë dalluese dhe çfarë përfaqëson ajo për ata.

**Ushqimi i Familjes:**

Kërkoni prej një fëmije të shkojë në tryezën e ushqimeve dhe të marrë ushqime për ju. Pasi t'ju shërbehët ushqimi të gjithë të rriturve, fëmija/fëmijët mund të shkojnë përsëri për të marrë ushqim për vete.

**Përrshëndetja eFAST® :**

Ndërsa e gjithë familja juaj qëndron në këmbë, ju lutemi prezantojeni veten dhe secilin prej anëtarëve të familjes me emrin dhe pastaj thoni, “*Ne jemi familja (thoni mbiemrin e familjes)*”. Pasi që i gjithë grupi përshëndet familjen tuaj, numëroni deri në tre dhe thoni “ Hello FAST Families”.

**Muzika/Kënga FAST®:**

Ju lutemi ngrini në këmbë të gjithë familjen për këngën. Ne do të fillojmë me sëpaku 2 këngë si “nxehje”. Ju lutemi i bëni me dije personelit, nëse familja juaj është e interesuar për ta nisur këngën e “nxehjes”. Më pas ne do të këndojmë Këngën FAST.

**Krijimet:**

Hapi 1: Dërgoni një fëmijë të tryeza e letrave për të marrë letër dhe lapsa për secilin anëtar të familjes. Jepjani këto letra dhe lapsa çdo anëtar të familjes  
Hapi 2: Udhëzoni secilin pjesëtar të familjes të skicojë diçka, pa u parë nga anëtarët e tjerë të familjes. Pasi të kenë përfunduar skicën, ose vizatimin, kthejeni përsëri atë tryezë.  
Hapi 3: Zgjidhni një prej pjesëtarëve të familjes të mbajë pikturat e secilit dhe lejoni, që anëtarët e tjerë të bëjnë pyetje në sensin pozitiv (p.sh më fol pak për pikturën tënde, ose përdorni pyetjet, kush, çfarë, ku dhe si). Sigurohuni që gjithësecili të kete mundësi të flasë për pikturat e tyre!

**Pantomimat e Ndjenjave:**

Duke qëndruar bashkë me familjen merrni secili nga një kartë ndjenjash, mbajeni atë të fshehur nga të tjerët dhe shkoni në tryezën tuaj. Zgjidhni një prej pjestarëve, i cili t'i shprehë ndjenjat e tij nëpërmjet pantomimës (pa shprehur fjalë) , ndërsa pjesa tjetër e familjes e ndjek atë. Porsa kjo pantomimë të arrijë të kuptohet nga pjestarët e tjerë të familjes, vazhdon një anëtar tjetër i familjes, deri sa të gjithë të arrijnë të shprehen nëpërmjet pantomimës. Nëse ka kohë të mjaftueshme, mund të përsëritni këtë lojë përsëri, me të tjera karta të ndjenjave..

Pas javës 3: Pasi pjestarët e familjes zgjedhën kartën e ndjenjave dhe kryen pantomimën e tyre, i pyetni ata për çka ndodhi dhe pse ata zgjedhën këtë ndjenjë, ndërsa pjestarët e tjerë e dëgjojnë me respekt.

**Lojë Speciale:**

Kjo është një kohë që e shpenzoni me fëmijën tuaj të klasës K-2, ku ju do të luani për 15 minuta. Lëreni fëmijën të zgjedhë një kuti loje speciale. Gjatë kohës së Lojës Speciale fëmija juaj do të jetë në veprim dhe ju do t'a ndiqni, pa e dekurajuar, pa e mësuar dhe pa e gjykuar atë.